



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
TASK-FORCË
NJËSIA OPERACIONALE SPECIALE

Nr. 482 prot.

Tiranë, më 13.08.2018

INFORMACION MBI VEPRIMTARINË E KRYER NGA NJOS, PËR
PERIUDHËN
01.07.2018-31.07.2018.

Njësia Operacionale Speciale (NJOS), në zbatim të kompetencave të përcaktuara në VKM Nr. 718 dt. 30.10.2014, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin 1086, datë 14.12.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Task-Forcës për përmirësimin e nivelit të arkëtimeve dhe uljen e nivelit të humbjeve në sistemin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike", Urdhërit Nr.37 dt.12.01.2018 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë "Për funksionimin e Njesisë Operacionale Speciale" dhe urdhërave të punës të miratuara nga Drejtuesi i Njesisë Operacionale Speciale për periudhën 01.07.2018-31.07.2018, ka ushtruar kontrole në disa drejtori rajonale të OSHEE sh.a. dhe ka arritur këto rezultate:

1. Janë kryer gjithsej **1379 kontrole** në terren.
2. Janë **proceduar penalisht 3 (tre) abonentë** që ushtronin aktivitet privat.
3. Është konstatuar **energji elektrike e pafaturuar** dhe energji e llogaritur nga gabimet në matësa, në sasinë prej **272.913 kwh**, e konvertuar në vlerë monetare **4.584.938 lekë**.
4. Është konstatuar **energji elektrike reaktive e pafaturuar** në sasinë **16148 kwhr**, e konvertuar në vlerë monetare **40.693 lekë**.
5. Janë arkëtuar nga **abonentët debitorë** shuma në vlerë monetare **6.704.997 lekë**.
6. Janë evidentuar 2 (dy) abonentë debitorë të cilët kanë hyrë në **aktmarrveshje për vlerën 5.437.514 lekë**.
7. Kemi konstatuar **452 raste me automatë më të mëdhenj** se pagesa e fuqisë që është e regjistruar në Billing Sistem.
8. Janë evidentuar **48 raste që duhet ndryshuar tarifimi i çmimit të energjisë**, nga të cilat:
 - **34 faturohen si familjar dhe ushtrojnë aktivitet si shërbim furnizimi, gjithashtu**
 - **14 raste që faturohen si furra buke por që ushtrojnë edhe aktivitete të tjera si pastičeri, market etj.**

Vlera totale e të ardhurave të evidentuara nga NJOS, për periudhën korrik 2018 është në masën 16.768.142 lekë.

Të ndara sipas drejtorive rajonale të OSHEE.sh.a, kontrollet e NJOS janë ushtruar si më poshtë:

- 116 kontrolle janë kryer në rajonin Tiranë.
- 327 kontrolle janë kryer në rajonin Shkodër.
- 66 kontrolle janë kryer në rajonin Berat.
- 38 kontrolle janë kryer në rajonin Fier.
- 226 kontrolle janë kryer në rajonin Gjirokastrë.
- 354 kontrolle janë kryer në rajonin Durrës.
- 252 kontrolle janë kryer në rajonin Vlorë.

